



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.58, datë 31.03.2022

PËR

MIRATIMIN E KOMENTEVE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE QË KANË APLIKUAR PËR PROVIMIN E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2022 -2023, PROFILI PROKUROR, TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenin 30, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189 dhe 190, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e komenteve të Raportit të vlerësimit paraparak të kandidatëve që kanë aplikuar për provimin e pranimit në Formimin Fillestar, për vitin akademik 2022 -2023, profili Prokuror, të Shkollës së Magjistraturës, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më datë 31.03.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

ALFRED BALLA

